
Data 25.05.2026

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndërrhyrje për përmirësimin e shtresave asfaltike, Rajoni 1 dhe 2 (Faza IV): Paketa II.”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7.

Fondi limit: 249,999,950.44 lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **financiare 2023, 2024, 2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e marrëveshjes kuadër në procedurën e prokurimit..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe pika 2/b e nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndermjet kufirit te lartë monetar dhe te ulet monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohe, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bazuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: "Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata." "

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, 2025** të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "b", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: "Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja b" të Ligjit nr. 1009/2009: "Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: "b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësisë ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii.ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël."

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlloritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Fature tatimore e situacionit perfunditar të deklaruar në organet tatimore
- Situacioni përfundimtar
- Akt kolaudimi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të ulët dhe kufirin e lartë monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve. Licenca duhet te permbajë kategoritë e punimeve të kontratës si me poshtë:

PER PUNIMET E PERGJITHSHME TE NDERTIMIT

NP 1 A Punime gërmimi në tokë.

NP 4 E Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.

NP-5	A	Punime nëntokësore, ura e vepra arti.
NP 12	A	Punime të inxhinierisë së mjedisit.

PER PUNIMET SPECIALE TE NDERTIMIT

NS 1	A	Punime për prishjen e ndërtimeve
NS 18	A	Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në Nr. 42, datë 16.01.2008).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

ARGUMENTIMI LICENCAT

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategori a e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1 A	Punime gjurmimi në tokë	<ul style="list-style-type: none"> - Germim dheu me ekskavator goma 0.25m³ në kanale gjeresi >2 m kat III me shk në mjet. - Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m³, në kanale gjeresi > 2 m, tokë zak, kategoria IV, me shk në mjet. - Germim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir . 	0-21 mln leke	5,072,288 leke

NP-4 E	Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale	<ul style="list-style-type: none"> - Skarifikim shtrese asfalti me makineri h=10cm. - Frezim shtrese asfalti me makineri h=1-3cm. - Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri. - Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri. - Shtrese stabilizant t=10cm. - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri 	Mbi 201- 400 mln leke	227,075,261 Leke
NP-5 A	Punime nëntokësore, ura e vepra arti	<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese binderi me zall lavatrice, 5cm, me makineri - Shtrese binderi me zall lavatrice, 3cm, me makineri (per profilim) - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri - Struktura monolite betoni C 20/25.(per kuneta, bordura, kanale, mure, puseta potrale etj.) - Shtrese çakelli t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri (per bankina) - Struktura monolite betoni C 20/25.(per kuneta, bordura, kanale, mure, puseta potrale etj.) - Shtrese çakelli t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri (per bankina) - F.V Tub metalik per tombino (me diameter dhe spesor te ndryshem sipas rastit) - Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni - Tombino me tuba betoni Ø 1000, mbi shtrese betoni 	0-21 mln leke	3,125,763 Leke
NP-12 A	Punime të inxhinierisë se mjedisit	<ul style="list-style-type: none"> - Transport dheu me auto deri 5.0 km 	0-20 mln leke	4,844,273 leke

NS-1 A	Punime per prishjen e ndërtimeve	<ul style="list-style-type: none"> - Skarifikim shtrese asfalti me makineri h=10cm. - Frezim shtrese asfalti me makineri h=1-3cm. 	0-20 mln leke	2,600,814 lekë
N.S-18. A	Punime topogjeodezike.	- Rilevim Topografik, piketime ne referim te raportit dhe specifikimeve teknike		0-20 mln leke

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të ketë stafin drejtues teknik të punësuar dhe regjistruar si më poshtë::

2 (dy) Inxhinier Ndërtimi

2 (dy) Inxhinier Hidroteknik

2 (dy) Inxhinier Gjeodet

1 (nje) Inxhinier Mjedisi

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 39 pika 6/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, projektin e zbatimit, specififikimet teknike, raportet teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin objektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale janë:

ARGUMENTIMI STAFI DREJTUES

Inxhinier Ndërtimi	Inxhinieri i ndërtimit nevojitet per organizimin e kantierit te ndërtimit, për ndjekjen në tërësi të punimeve dhe bën koordinim e të gjithë personelit teknik në objekt për mbarëvajtjen e punimeve sipas projektit të zbatimit dhe grafikut të parashikuar në kontratë. (Referuar zërave të punimeve të preventivit)
Inxhinier Hidroteknik	Inxhinieri hidroteknik nevojitet për ndjekjen e punimeve të kullimit të ujërave, tombinove; (Referuar zërave të punimeve të preventivit).
Inxhinier Gjeodet	Inxhinieri gjeodet nevojitet për piketimin fillestar të objektit dhe piketimin në vazhdimësi të të gjithë punimeve sipas proceseve të punës. (Referuar zërave të punimeve të preventivit).
Inxhinier Mjedisi	Inxhinieri i mjedisit nevojitet per ndjekjen e punimeve të gjurmimit me qëllim ruajtjen e gjelbërimit, ruajtjen e ambientit gjate kryerjes se punimeve; përcaktimin/selektimin e pikës se depozitimit se hedhurinave dhe materialeve te dala nga gjurmimi. (Referuar zërave te punimeve te preventivit).

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 2 (dy) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- CV

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merren masa për ndërprerjen e kontratës

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Argumentimi 2.3.4: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Punonjesi i sigurisë dhe shëndetit nevojitet për të kontrolluar dhe minimizuar rreziqet që mund të ndodhin gjatë punës në kantier. Kërkesat e mësipërme mbështen në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM

nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjes e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqytjes. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës. Punonjësit "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" rekomandohen të jete ne kantier per minizimin e aksidenteve ne pune.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 20 persona për periudhën, tremujoje nga data e zhvillimit te procdures e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhen tre mujor e nga data e zhvillimit të tenderit,

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Ne përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushes ka bere nje analize bazuar tek faktoret, si volumet dhe kategorite e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zerat e punimeve dhe oret e punes dhe pagen minimale te lejuar qe duhen per te permbushur kontratesn. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre ne pune me koheshtrirje (3 mujore nga momenti i hapjes, tregon besueshmëri per autoritetin qe, operatori do te permbushë kontraten. Dëshmia e kërkuar per numrin e fuqise punetore te operatorit ekonomik e nevojshme per ekzekutimin e objektit te kontrates, eshte dokument qe verteton kapacitetin teknik dhe profesional te operatorit, persa kohe jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve ne regjistrin e sigurimeve eshte nje detyrim ligjor i punedhënesit e parashikuar nga Kadi i Punes, per rrjedhoje vertetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqeruara me listpagesat me kete koheshtrirje eshte dokument vertetues per qendrueshmerine e te punesuarve, pervojen e tyre, dhe jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates. Punesimi i nje numri te caktuar, pervec; besueshmerise se operatoreve ekonomik, si nje nga kerkesat themelore te kualifikimit, perpiqet te kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit ne tregun e punes. Po ashtu eshte nje tregues i kualifikimit dhe eksperiences qe duhet te kete kjo kategori e punonjësve. Vendorsja e kriterit duke perfshire dhe stafin teknik, eshte ne perputhje me volumin e punes, natyren dhe terrenin ku do te kryhen punimet. Kriteri per kualifikim eshte vendosur qe t'i sherbeje autoritetit per te njohur gjendjen e kapaciteteve te operatoreve te cilet nepermjet dokumentacionit te vertetojne se zoterojne, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshem, si dhe kapacitetet organizative, gjithcka rie funksion te realizimit me sukses te kontrates.

Analizat teknike jane bazuar ne VKM nr. 216, date 13.4.2023 "Per krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar perinformatizimin e manualit te cmimeve per zerat e punimeve ne ndertim" Bazuar ne kater elementet e struktures se kosos (material, punetori, makineri, transport) zeri fuqi punetore ze rreth 20% te kosos.

Total orë pune (Specialist + Punëtor+manovrator=kamionist) = 48,558 orë (sipas zbërthimit të analizave)
Ore/1 ditë pune= 8 ore

Total Ditë pune punëtori= 48,558 orë/8 orë= 6,070 ditë pune Dite pune gjithsej= 24 muaj * 22 ditë/muaj= 528 ditë pune

Numri i fuqisë punëtore = 6,070 dite pune /528 ditë ≈ 12 punëtore

Sqarim: Për shkak të arsyeve të mëposhtme fuqia punëtore duhet të jetë me e lartë sesa ajo e llogaritur:

1. Objekti realizohet në kuadër të një marrëveshjeje kuadër, ku kontratat specifike mund të zhvillohen paralelisht në disa kantiere ndërtimi. Për këtë arsye, operatori ekonomik duhet të disponojë kapacitetet njerëzore të mjaftueshëm për realizimin e punimeve.
2. Kohëzgjatja e realizimit të punimeve është 24 muaj. Gjatë kësaj periudhe mund të ketë ndërprerje të proceseve të punës për shkak të kushteve atmosferike, reshjeve, lagështisë dhe temperaturave të ulëta. Punimet e asfaltimit dhe betonimit kërkojnë temperatura mbi 5°C dhe kushte atmosferike të përshtatshme.
3. Ecuria e proceseve të punës nuk është uniforme gjatë gjithë periudhës së zbatimit. Në faza të caktuara të punimeve mund të kërkohej angazhimi paralel i disa ekipeve të punës dhe i një numri më të madh punonjësish.
4. Në kuadër të realizimit të kontratave specifike, operatori ekonomik duhet të garantojë vazhdimësinë e proceseve të punës, disponueshmërinë e stafit teknik dhe operacional, si dhe zëvendësimin e menjëhershëm të personelit në raste mungesash apo ngarkese të shtuar pune.

Për shkak të arsyeve të mësipërme dhe bazuar në eksperiencën e punimeve të ngjashme është pranuar që numri i fuqisë punëtore të jetë jo me i vogël se **20 persona. (12+8=20 punëtore)**

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme në pronësi, ose qira, ose kontrate furnizimi.

Nr.	Mjeti	Sasia (copë)	Statusi
1	Eskavator me zinxhire	4	në pronësi ose me qira
2	Eskavator me goma	2	në pronësi ose me qira
3	Fadrome me goma	2	në pronësi ose me qira
4	Eskavator me zinxhirë i pajisur me çekiç	2	në pronësi ose me qira
5	Minieskavatore 2 deri 9 ton	4	në pronësi ose me qira
6	Bob Cat	2	në pronësi ose me qira
7	Kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	6	në pronësi ose me qira
8	Kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 30 ton	6	në pronësi ose me qira
9	Kamionçine me kapacitet mbajtës deri 2 ton	4	në pronësi ose me qira

10	Kamion i pajisur me vinç	2	në pronësi ose me qira
11	Impiant prodhim asfalti i pajisur me leje mjedisi	1	në pronësi ose me qira ose kontrate furnizimi
12	Asfaltoshtruese	2	në pronësi ose me qira
13	Rrul asfalti Gome-Cilinder 2 – 6 ton	2	në pronësi ose me qira
14	Rrul asfalti Cilinder-Cilinder 4 – 6 ton	2	në pronësi ose me qira
15	Rrul asfalti Gome-Gome mbi 8 ton	2	në pronësi ose me qira
16	Sharre/prerese asfalti	2	në pronësi ose me qira
17	Freze asfalti mbi 18 ton	1	në pronësi ose me qira
18	Freze asfalti	2	në pronësi ose me qira
19	Fshese asfalti	2	në pronësi ose me qira
20	Fshese asfalti me aspirim	1	në pronësi ose me qira
21	Nyje per prodhim inert i pajisur me leje mjedisi	1	në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi
22	Rrul Gome-Cilinder me peshe mbi 18 ton	2	në pronësi ose me qira
23	Rrul Gome-Cilinder me peshe mbi 10 ton	2	në pronësi ose me qira
24	Rrul ngjeshes me vibrim deri 5 ton	2	në pronësi ose me qira
25	Grejder	2	në pronësi ose me qira
26	Autobot uji	2	në pronësi ose me qira
27	Betoniere kantieri 500 liter	2	në pronësi ose me qira
28	Semafore sinjalistike per punime rrugore	2	në pronësi ose me qira
29	Tabela sinjalistike provizore (sigurimin teknik)	60	në pronësi ose me qira
30	Zyre kantieri e levizshme (mobile)	2	në pronësi ose me qira
31	Kompresor	2	në pronësi ose me qira
32	Gjenerator	2	në pronësi ose me qira
33	Vibrator betoni	4	në pronësi ose me qira

Pajisjet dhe mjetet nuk duhet te jene te angazhuara në asnjë kontratë tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira, do të paraqiten keto dokumenta:

- a) Për mjetet ne pronesi (që shënohen në regjistra publikë), duhet të paraqiten;- dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), -plus certifikaten e kontrollit teknik, -siguracionin e mjetit (te vlefshme), vertetimin e pageses per taksat vjetore.
- b) Për mjetet e siguruara me qira, duhet të paraqiten; -dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme), vertetimin e pageses per taksat vjetore, kontrata e qirase e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.

Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara, do te jene te angazhuara vetem ne kete kontrate. Mjetet te cilat rezultojne te angazhuara ne kontrata te tjera afati i zbatimit te cilave shtrihet pergjate afatit te kontrates objekt i prokurimit jane shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimi, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Për numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira / kontrate furnizimki janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asetë të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

ARGUMENTIMI I MJETEVE

Mjetet	Sasia (copë)	Proceset e punës
Ekskavator me zinxhir	4 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Germim dheu me ekskavator goma 0.25m³ ne kanale gjeresi >2 m kat III me shk ne mjet. - Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet. -
Ekskavator me goma	2 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Germim dheu me ekskavator goma 0.25m³ ne kanale gjeresi >2 m kat III me shk ne mjet. - Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet.
Eskavator me zinxhirë i pajisur me çekiç	2 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Germim shkambi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir
Fadrome me Goma	2 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri.
Miniekskavatore 2 deri ne 9 Ton	4 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Germim dheu me ekskavator goma 0.25m³ ne kanale gjeresi >2 m kat III me shk ne mjet.
BobCat	2 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri
Kamione vetshkarkues mbi 20 Ton	6 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Transport dheu me auto deri 5.0 km - Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri. - Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri. - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobetoni) me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri.
Kamione vetshkarkues mbi 30 Ton	6 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Transport dheu me auto deri 5.0 km - Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri. - Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri.

		<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri
Kamioncine me kapacitet deri ne 2 Ton	4 cope	<ul style="list-style-type: none"> - F.V Tub metalik per tombino (me diameter dhe spesor te ndryshem sipas rastit) -
Kamion i Pajisur me Vinc	2 cope	<ul style="list-style-type: none"> - F.V Tub metalik per tombino (me diameter dhe spesor te ndryshem sipas rastit) - Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni - Tombino me tuba betoni Ø 1000, mbi shtrese betoni.
Impiant prodhimi Asfalti i pajisur me leje Mjedisi.	1 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese binderi me zall lavatrice, 5cm, me makineri - Shtrese binderi me zall lavatrice, 3cm, me makineri (per profilim) - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri
Asfaltoshtruese	2 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese binderi me zall lavatrice, 5cm, me makineri - Shtrese binderi me zall lavatrice, 3cm, me makineri (per profilim) - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri

Rrul asfalti Gome-Cilinder 2 – 6 ton	2 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri. - Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri. - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri -
Rrul asfalti Cilinder-Cilinder 4 – 6 ton	2 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese binderi me zall lavatrice, 5cm, me makineri - Shtrese binderi me zall lavatrice, 3cm, me makineri (per profilim) - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me - makineri
Rrul asfalti Gome-Gome mbi 8 ton	2 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri. - Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri. - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri
Sharre/prerese asfalti	2 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri

Freze asfalti mbi 18 ton	1 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri - Skarifikim shtrese asfalti me makineri h=10cm. - Frezim shtrese asfalti me makineri me thellesi deri ne 20cm
Freze asfalti	2 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri - Frezim shtrese asfalti me makineri h=1-3cm.
Fshese asfalti	2 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri - Skarifikim shtrese asfalti me makineri h=10cm. - Frezim shtrese asfalti me makineri h=1-3cm.
Fshese asfalti me aspirim	1 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri - Skarifikim shtrese asfalti me makineri h=10cm. - Frezim shtrese asfalti me makineri h=1-3cm.
Nyje per prodhime inerti e pajisur me leje mjedisore	1 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri. - Shtrese cakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri.
		<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri

Rrul ngjeshes me vibrim deri 5 ton	2 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri. - Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri. - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri - Shtrese çakelli t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri (per bankina)
Rrul Gome-Cilinder me peshe mbi 10 ton	2 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri. - Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri. - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri
Rrul Gome-Cilinder me peshe mbi 18 ton	2 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri. - Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri. - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri
Greider	2 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri. - Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri.

Autobot Uji	2 cope	- Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri. - Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri.
Betoniere kantieri 500 liter	2 cope	- Struktura monolite betoni C 20/25.(per kuneta, bordura, kanale, mure, puseta potrale etj.)
Semafore sinjalistike per punime rrugore	2 cope	- Per organizmin dhe mbarevajtjen e proceseve te punes, rritjen e sigurise dhe shendetit ne pune gjate ekzekutimit te punimeve.
Tabela sinjalistike provizore (sigurimin teknik)	60 cope	- Per organizmin dhe mbarevajtjen e proceseve te punes, rritjen e sigurise dhe shendetit ne pune gjate ekzekutimit te punimeve.
Zyre kantieri e levizshme (mobile)	2 cope	- Per organizmin dhe mbarevajtjen e proceseve te punes.
Kompresor	2 cope	- Struktura monolite betoni C 20/25 (per kuneta, bordura, kanale, mure, puseta portale etj.)
Gjenerator	2 cope	- Struktura monolite betoni C 20/25.(per kuneta, bordura, kanale, mure, puseta potrale etj.)
Vibrator betoni	4 cope	- Struktura monolite betoni C 20/25.(per kuneta, bordura, kanale, mure, puseta potrale etj.)

2.3.7 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilesisë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (ekuivalent)
- ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (ekuivalent)

- ISO 45001 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (ekuivalent)

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH, etj., mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vëndndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rendësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit nr. 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Shënim:

Mbi mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera

*Në mbështetje të nenit 84, pika 7, të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 90, pika 6, të VKM nr. 285/2021, Autoriteti Kontraktor vlerëson se operatorët ekonomikë **nuk mund të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera** për kriteret që lidhen drejtpërdrejtë me realizimin e proceseve kryesore të kontratës, konkretisht:*

- *përvojën e mëparshme të ngjashme;*
- *personelin/stafin kryesor;*
- *fuqinë punëtore minimale;*
- *licencat profesionale të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate.*

Këto kapacitete konsiderohen thelbësore për realizimin e kontratës, pasi lidhen drejtpërdrejt me organizimin e punimeve, koordinimin e zbatimit në kantier, përputhshmërinë me specifikimet teknike dhe kërkesat ligjore, si dhe kontrollin e cilësisë dhe sigurisë gjatë realizimit të punimeve objekt kontrate. Autoriteti Kontraktor vlerëson se mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera për këto kriteret mund të cenojë realizimin efektiv dhe të besueshëm të kontratës. Për këtë arsye, këto kapacitete duhet të disponohen dhe të angazhohen drejtpërdrejtë nga operatori ekonomik ose anëtari përkatës i BOE që do të realizojë punimet, me qëllim garantimin e përgjegjshmërisë, cilësisë së ekzekutimit dhe minimizimin e riskut gjatë zbatimit të kontratës

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Projekti teknik, Specifikimet teknike, raportet teknik, preventivi me zerat e punimeve, grafiku janë hartuar nga subjekt projektues të licencuar dhe jane pjese e DST.

Ne çdo rast nese jane permendur marke prodhimi ose proces i vecante ne dokumentet e tenderit, specifikimet teknike ne kete procedure prokurimi do te pranohen edhe ekuivalent.

ARGUMENTIMI I KRITEREVE PËRZGJEDHËS PËR KUALIFIKIM

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) A) **Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X**

Sipas rëndësisë:

- | | |
|--|-----------------|
| 1. Çmimi | pikët 65 |
| 2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë | pikët 15 |
| 3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) | pikët 10 |
| 4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%) | pikët 5 |
| 5. Siguria ne kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %) | pikët 5 |

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehin në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Kriteri:

1. Çmimi

[0 - 65] pikë

Argumentimi: Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.
Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\text{mink1}} \times P_{\text{maxk1}} / O_{k1}$$

P_{k1}	Pikët e kriterit që vlerësohet
V_{mink1}	Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet
P_{maxk1}	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k1}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, refuzohen pa kërkuar shpjegime.

2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë [0 –15 pikë]

Argumentimi: Operatori Ekonomik për të vlerësuar për këtë kriter duhet të provojë se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën të stafit që është emëruar në eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve dhe volumeve specifike si me poshte:

- Punime shtesë asfaltbetoni me sipërfaqe jo më pak se 74,026.00 m² për kontrata të kryera gjatë tre viteve të fundit *15 pikë*

* Ky është kriter vlerësimi dhe si i tillë operatorët ekonomik nuk do të skualifikohen por do të vlerësohen, bazuar në sasinë dhe përmbushjen e kushtit të afatit 3 vjeçar nga data e shpalljes së kontratës objekt prokurimi. Kriteri është vendosur për të treguar organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës. Vlera e kontratave të mëparshme dhe specifikisht vlera e punimeve dhe volumeve të kryera të realizuara, ndikon në disa aspekte të përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë, sikurse janë: i. stabiliteti financiar dhe kapaciteti; -cilësia dhe standardet; -historia e suksesit; -trajtimi i kompleksitetit Për të vlerësuar për këtë kriter operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ekonomik duhet të plotësojë minimalisht vlerën e kërkuar. Nëse kjo vlerë minimale nuk plotësohet do të konsiderohet se operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ka marrë “0” pikë.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2} = O_{k2} \times P_{\text{maxk2}} / V_{\text{maxk2}}$$

P_{k2}	Pikët e kriterit që vlerësohet
V_{maxk2}	Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e punimeve specifike të kryera)
P_{maxk2}	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k2}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Permbushja e këtij kriteri do të provohet nepermjet situacioneve perfundimtare, aktit të kolaudimit sipas pikës 2.3.1 të Kapacitetit Teknik, dorezimit të de tyrueshem të informacionit të përmbledhur sipas formatit të

vetedeklarimit bashkelidhur (Aneks 1) dhe cdo dokumentacion provues (sipas rastit) per volumet e kerkuara (leje ndertimi, projekti etj).

Volumet specifike per kontrata te cilat nuk jane kolauduar nuk do te perfshihen ne perlllogartje.

Argumentim:

“Punime shtresë asfaltobetoni me sipërfaqe jo me pak se 74,026.00 m² për kontrata të kryera gjatë tre viteve të fundit”

Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejtë me natyrën e objektit të prokurimit: “Ndërhyrje për përmirësimin e shtresave asfaltike, (Faza IV):Paketa II”, e cili përfshin realizimin e punimeve infrastrukturore dhe ndërtimore në shtresa rrugore/asfaltike.

Përcaktimi i sipërfaqes minimale prej 74,026.00 m² është referuar bazuar në volumet e parashikuara në preventivin e punimeve dhe synon të garantojë se operatori ekonomik disponon eksperiencë të mjaftueshme në realizimin e punimeve të ngjashme për nga natyra, përmasat dhe kompleksiteti teknik. Në këtë mënyrë, autoriteti kontraktor sigurohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet e nevojshme teknike, organizative dhe logjistike për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa që kontratat të jenë realizuar gjatë tre viteve të fundit synon të vërtetojë kapacitetin aktual teknik dhe organizativ të operatorit ekonomik, si dhe faktin që eksperiencia e paraqitur reflekton standardet bashkëkohore të realizimit të punimeve infrastrukturore të ngjashme.

Shënim:

*Në mbështetje të nenit 84, pika 7, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 90, pika 6, të VKM nr. 285/2021, për këtë kriter **nuk lejohet mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera.***

Autoriteti Kontraktor vlerëson se aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë përbëjnë aspekte kritike të kontratës dhe lidhen drejtpërdrejtë me cilësinë, organizimin teknik dhe realizimin efektiv të punimeve objekt prokurimi.

Për këtë arsye, kriteri duhet të përmbushet drejtpërdrejtë nga operatori ekonomik ofertues ose nga anëtari përkatës i bashkimit të operatorëve ekonomikë që do të realizojë punimet përkatëse.

3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0–10 pikë]

Argumentimi: Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qenë i detyruar ti zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryeje. Referuar në nenin 45 të VKM nr.285/2021, kriteri i ofertës ekonomiksht më të favorshme bazohet në, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur për më pak se dy vjet do të skualifikohet. Çdo ofertues i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh dhe paisjesh përfshirë për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet si më poshtë:

$$P_{k3} = O_{k3} \times P_{\max k3} / V_{\max k3}$$

P_{k3} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k3}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k3}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k3} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 2)

4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)

[0 - 5 pikë]

Argumentimi: Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, vlerat e garancive më të larta e detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi.

- **Autoriteti kontraktor do të mbajë garancinë e punimeve sipas përcaktimeve të legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në vlerën prej minimalisht 5 %.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë garancie punimesh më të ulët se 5% do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme e cila nuk respekton përcaktimet ligjore për vlerën e garancisë.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë garancie punimesh më të lartë se 5% do të vlerësohet si më poshtë:**

Pikët për këtë nën-kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k4} = O_{k4} \times P_{\max k4} / V_{\max k4}$$

P_{k4} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k4}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k4}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k4} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

Shënim: Vlera e garancise se punimeve ne % e ofruar nga OE, do te ndalohet nga çdo pagese pjesore ne shumen e caktuar te vleres se situacionit pjesor si garanci e defekteve. Kjo sipas përcaktimeve të kushteve të kontrates, (Shtojca 18 e dokumenteve të tenderit) Neni 10, pika 10.5.

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese garancine sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

5. Siguria ne kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %)

[0 - 5 pikë]

Argumentimi: Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese oferten per vleren PSK ne rubriken specifike/zerin “Siguria ne kantier (Plani I Sigurise e Kordinimit ne Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit) sipas Vendimit nr. 216, date 13.04.2023)”, ne preventivin e ofertes:

Standarti gjatë zbatimit të punimeve është i lidhur ne mënyrë të posacme edhe me përmbushjen nga ana e kontraktorit të të gjitha masave të marra dhe të ndjekura në mënyrën e duhur, sa i përket ceshtjeve të sigurisë

në kantier, shëndetit, impaktin në mjedis dhe social që kanë punimet e kryera. Siguria e shtuar dhe shëndeti në punë ka të bëjë me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes të shëndetit të punëmarrësve, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimin, konsultimin, pjesëmarrjen e balancuar si dhe trajnimin e formimin e punëmarrësve e përfaqësuesve të punëmarrësve në përputhje me legjislacionin përkatës.

Siguria në kantier, përfshin Planin e Sigurisë e Kordinimit në Kantier (PSK), menaxhimin e trafikut dhe kontrollin (më tej shtjelluar në Relacionin Teknik dhe aktet nenligjore përkatëse të referuara). Ky parashikim shërben në mënyrë të veçantë për përmirësimin e kushteve të punës së punëmarrësve, në mënyrë që të shmangen/zvogëlohen aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe të përmbushen të drejtat e punëmarrësve për punë të denjë të krahasueshme me vendet e tjera të BE-së.

Për shkak të rëndësisë që paraqesin këto detyrime për kontraktorin është parashikuar një rubrike e veçantë në preventivin e punimeve si zë më vete dedikuar sa më lart. Kjo rubrike bazohet në Vendimin Nr. 216, datë 13.4.2023 *“Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”* (Neni 13, Pika 3).

Fondi i veçantë për këtë rubrike në masën jo më pak se 3%, përlogaritur në përputhje me madhësinë e projektit që do të realizohet sipas percaktimeve të VKM nr. 216 datë 13.04.2023. Ky fond parashikohet shprehur në vlerë, në këtë rast jo më pak se **7,499,998.51 leke pa tvsh**. Ofertuesi nuk duhet të plotësojë formularin e ofertës nën vlerën minimale. Kjo vlerë minimale shërben për zbatimin e masave të shtuara për sigurinë në kantier, në zbatim të Vendimit nr. 312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”*, Aneksi VI *“Përmbajtja minimale e planit të sigurisë në kantieret e perkoheshme e të levizeshme”*.

Në vijim, për kriterin: Standarti dhe Cilësia: Siguria në kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social, propozimi i ofertuesit do të konsiderohet vlera e ofertuar nga operatori ekonomik për zërin Siguria në kantier (Planin e Sigurisë e Kontraktorit në Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollin të shtuar), e përfshirë në ofertën ekonomike të detajuar, konkretisht sipas Shtojcës 2 të DT. **“LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT”**

- **Kontraktori do të ofertojë për këtë zë (PSK) minimalisht vlera 7,499,998.51 leke pa tvsh.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë më të ulët se vlera 7,499,998.51 leke pa tvsh do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme (konsiderohet sikur ka sjellë volume pune më pak)**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë PSK – Sigurie në kantier më të lartë se vlera 7,499,998.51 leke pa tvsh do të vlerësohet si më poshtë:**

Pikët për këtë nën-kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = O_{k5} \times P_{\max k5} / V_{\max k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k5}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k5}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ofertat anomalisht të ofruara për kriterin: Siguria ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social (PSK)

Në rast kur është një ofertë e vlefshme, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Siguria e shtuar ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social (PSK)”, **kur ofrohet më shumë se dyfishi i vlerës së kërkuar.**

Në rast se janë më shumë se dy oferta, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Cilesia ne punime: siguria ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social” **nëse vlera e saj do të jetë më shume se dyfishi i mesatares së ofertave të vlefshme.**

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendeti impakti ne mjedis”, në rastin kur ekzistojnë dy ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

$$\begin{aligned} O & \quad - \text{(pikët e Ofertës)} \\ Mo & \quad - \text{Mesatarja e pikëve të ofertave të vlefshme} \\ N & \quad - \text{Numri i ofertave të vlefshme} \\ PR (Rm) & \quad - \text{Rritje e mundshme} \\ Mo & \quad = O_1 + O_2 + O_3 + \dots + O_n / N \\ PR & \quad = 200 \% Mo \end{aligned}$$

Vlera e ofertave të ofruara > PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendeti impakti ne mjedis”.

Kujdes!!!

Për ofertën që do të konsiderohet anomalisht e ofruar për këtë kriter, ofertuesi do të vlerësohet gjithësesi me të njëjtat pikë sikurse ofertuesi me pikët më të ulëta për këtë kriter.

Në rast se ky ofertues përsëri shpallet fitues, PSK do të përllogaritet në bazë të ofertës së ofertuesit pavarësisht pikëve të marra.

Shembull: PSK është caktuar 15,000,000 lekë. Ofertuesi A ka ofruar 15,000,000 lekë, B 16,000,000 lekë, C 17,000,000 lekë dhe D 55,000,000 lekë. Sipas pikëve për këtë kriter ofertuesin përfitojnë pikët respektivisht A – 1.36 pikë, B – 1.45 pikë, C -1.55 pikë dhe D – 5 pikë të plota.

Pas formulës për anomalisht të ofruar rezulton se ofertuesi D është anomalisht i ofruar për PSK (200% MO = 51,500,000 leke < 55,000,000 leke) dhe vlerësohet me 0 pike.

Ne rastin kur Ofertuesi D merr piket maksimale per kriteret e tjera vleresuese, pra ne rastin kur Ofertuesi D shpallet fitues vlera per PSK do te jete 55,000,000 leke.

Autoriteti Kontraktor ben likujdimin e vleres se sipercituar per sigurine ne kantier ne cdo situacion mujor referuar peshës respektive/korresponduese te realizimit te punimeve, kjo e shoqeruar me (i) raportin PSK

(referuar permbajtjes minimale te PSK) hartuar nga Kontraktori e (ii) Mbikqyresi i punimeve dhe (iii) i monitoruar e miratuar nga specialistet e HSE (Health, Safety and Environment) te autoritetit kontraktor.

Theksohet se, nese nga monitorimi i specialisteve te HSE dhe Mbikqyresit te punimeve rezulton se nuk jane zbatuar masat e sigurise ne kantier (kjo nënkupton edhe nëse ka një shkelje të vetme) pervec masave penalizuese referuar KPK dhe KVK te kontrates, vlera korresponduese per kete rubrike nuk do te paguhet për situacionin mujor referues.